



RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

**mbi Kërkesën e Mëtejshme për Rishikim të Aspektit të Miradministrimit
në lidhje me**

**Vendimin e Avokatit të Popullit mbi hetimin e Ankesës së Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit
Haxhi Shalës dhe Isni Kilajt kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Kërkesës
që Avokati i Popullit të ushtrojë kompetencën e tij sipas nenit 49(5) të Ligjit nr.05/L-053
për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”)
për t’i referuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese aspektin e
kushtetutshmërisë së Rregullores KSC-BD-25/Rev1**

Nr. OMB-C-2024-02/03

Lëshuar më 10 korrik 2024

PUBLIK

Më 10 korrik 2024, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës (‘Avokati i Popullit’),

Pasi mori në shqyrtim kërkesën e lartpërmendur për të trajtuar aspektin e mungesës së miradministrimit prej Administratores në miratimin e Rregullores për Ndihmë Juridike të Rishikuar, e vitit 2024, merr këtë vendim:

I. PROCEDURA PARA AVOKATIT TË POPULLIT

1. Kërkesa e mëtejshme për rishikim u regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më 22 maj 2024.

II. FAKTET

2. Faktet e çështjes të cilat çuan në ankesën e parë, janë shtjelluar në raportin e parë, OMB-C-2024-02/01.¹

¹ [Shih Report of the Ombudsperson in OMB-C-2024-02, at Section II](#), (Raport i Avokatit të Popullit OMB-C-2024-02/02) dhe [KSC-CC-2024-23](#)



3. Kërkesa për rishikim të Vendimit të parë dhe të vlerësimit të Avokatit të Popullit janë shtjelluar në OMB-C-2024-02/02.²

III. KËRKESA E MËTEJSHME PËR RISHIKIM (Kërkesa në lidhje me miradministrim)

4. Kërkesa për rishikim të mëtejshëm përmban një kërkesë të mbrojtësve të parashtruesve të ankesës, në të cilën kërkohet që Avokatit të Popullit të trajtojë ankesën e tyre në lidhje me keqadministrim, konkretisht moskonsultim ose mosnjoftim nga Administratorja për miratimin e Rregullores për Ndihmë Juridike të vitit 2024.
5. Në emër të parashtruesve, mbrojtësit iu referuan:
 - a. Parashtrimeve të mëparshme të tyre drejtuar Avokatit të Popullit, të datës 25 prill 2025 dhe 9 maj 2024. Në këto parashtrime, mbrojtësit përsëritën se Rregullorja e Rishikuar u miratua “pa njoftim ose pa konsultim”. Parashtruesit thanë se Rregullorja KSC-BD-25/Rev1 u miratua në mungesë të procesit të konsultimit dhe argumentuan se procesit, i cili çoi në vendim administrativ, nuk u administrua mirë nga ana e Administratores.
 - b. KSC-CC-2024-23/F00001, Parashtrimin të Parë të Mbrojtësve drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK), dhe argumenteve të paraqitura aty në lidhje me aspektin e miradministrit.
 - c. Në parashtrimin e tyre drejtuar DHSGJK-së, parashtruesit argumentuan se:
 - i. Moskonsultimi ose mosnjoftimi përbën shembull të keqadministrit;
 - ii. Parashtruesit përbëjnë “dukshëm palë të interesuara” në Rishikimin e Rregullores, megjithëse ata as u konsultuan, as u informuan;
 - iii. Megjithëse sipas rregullës 3(2) e Rregullores së vitit 2020 Administratorja duhet të mbajë një evidencë të procedurës së ndryshimeve e cila i mundëson që ta bëjë atë publike, dhe megjithëse Kushtetuta përcakton një të drejtë të përgjithshme për

[Referral by \(1\) Sabit Januzi, \(2\) Ismet Bahtijari and \(3\) Haxhi Shala to the Specialist Chamber of the Constitutional Court regarding the Constitutional Validity of KSC-BD-25/Rev1, 2 April 2024](#) (Kërkesë Referuese nga (1) Sabit Januzi, (2) Ismet Bahtijari dhe (3) Haxhi Shala drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me aspektin e kushtetutshmërisë së Rregullores KSC-BD-25/Rev1, 2 prill 2024).

² Shih [Report of the Ombudsperson in OMB-C-2024-02/02](#) (Raport i Avokatit të Popullit OMB-C-2024-02/02)



- qasje në dokumente publike, përfshirë në dokumente të institucioneve publike dhe organeve të autoriteteve shtetërore siç është, nga ajo u kërkua që të bëjë publik procesin e ndryshimeve të cilën ajo e refuzoi, pa dhënë asnjë arsytim;
- iv. Se keqadministrimi është pengesë në realizimin e të drejtave të njeriut;
 - v. Parashtruesit argumentojnë se, megjithëse rregulla 3 e Rregullores së vitit 2020 përcakton mundësinë për ndryshime të tjera, përfshirë, *proprio motu*, nga Administratorja, aty parashikohet qartë se propozimet për ndryshime duhet të jenë të “arsyetuara” dhe të përfshijnë konsultime me një organ përfaqësues të pavarur të mbrojtësve të specializuar.

IV. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

A) Mungesa e konsultimit

6. Roli i Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara të Kosovës është të monitorojë, mbrojë dhe ruajë të drejtat dhe liritë e personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Juridiksioni i Avokatit të Popullit të, sikurse përcakton rregulla 29(2)(a) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (‘Rregullorja’) të kryejë hetime në lidhje me ankesa të paraqitura prej cilitdo personi që pretendon shkelje të drejtave nga Dhomat e Specializuara (‘DHS’) ose nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.
7. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit mund të shqyrtojë vetëm veprime ose mosveprime nga DHSK-ja dhe ZPS-ja në rast se ato kanë rezultuar në një ndërhyrje të papërligjur, ose një shkelje të të drejtave themelore të personave që ndërveprojnë me këto institucione.
8. Gjithashtu, në përputhje me rregullën 29(3)(b), një kërkesë drejtuar Avokatit të Popullit mund të hidhet poshtë në qoftë se nuk vërteton shkelje të të drejtave të njeriut.
9. Sa i përket aspektit në fjalë, Avokati i Popullit rikujton se Rregullorja e miratuar nga Administratorja për të administruar sistemin e ndihmës juridike miratohet në bazë të nenit 19(6) të Ligjit i cili thotë se “*Dhomat e specializuara kanë kompetencë për të miratuar rregulla, politika dhe praktika të brendshme të cilat janë të nevojshme për*



funksionin e tyre të duhur, sigurinë apo drejtësinë e procedurës apo për t'i zbatuar dispozitat e këtij ligji.”

10. Avokati i Popullit rikujton gjithashtu rregullën 3(1) të Rregullores së Ndihmës Juridike së vitit 2020 e cila thotë: *“Administratori mund ta ndryshojë këtë Rregullore proprio motu ose mbi bazën e propozimeve për ndryshime. Kryetari dhe Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar mund t'i paraqesin Administratorit propozime të arsyetuara për ndryshime. Administratori **mund** të këshillohet me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar në lidhje me çdo propozim për ndryshim.”* (theksimi i shtuar)
11. Nga rregulla 3(1) është e qartë se nuk ka kusht ligjor që Administratorja të konsultohet me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar (OPPMS) për **asnjë propozim për ndryshime**. Në fakt, diskrecioni për konsultim është vetëm për propozime për ndryshime nga Kryetarja dhe OPPMS-ja dhe jo për ndryshime, të paraqitura nga Administratorja, *proprio motu*. Gjithashtu, nuk përmendet konsultimi i mëtejshëm me palë të interesuara.
12. Parashtruesit mund të jenë të mendimit se nuk pati konsultim për procesin i cili çoi në prezantimin e Rregullores për Ndihmë Juridike të vitit 2024, por në realitet Administratorja nuk detyrohet me ligj të konsultohet me askënd në lidhje me ndryshime dhe ajo ka diskrecion të konsultohet me OPPMS-në vetëm lidhur me propozime për ndryshime nga Kryetarja dhe OPPMS-ja.
13. Avokati i Popullit nuk do të shqyrtojë asnjë parashtrim të parashtruesve në lidhje me mungesë të konsultimeve me OPPMS-në, sepse ata nuk kanë *locus standi* në këtë drejtim dhe nuk mund të konsiderohen si përfaqësues të OPPMS-së.
14. Në lidhje me të katër parashtruesit, Avokati i Popullit thekson se më 22 shkurt 2024, ose para kësaj date, asnjëri prej katër parashtruesve nuk i kishte paraqitur Dhomave të Specializuara të Kosovës kërkesë për ndihmë juridike në bazë të Rregullores për Ndihmë Juridike të vitit 2020. Në fakt, Avokati i Popullit ka informacion se të katër parashtruesit u kishin paraqitur kërkesa për ndihmë juridike autoriteteteve të Kosovës.
15. Kërkesat për ndihmë juridike nga të katër parashtruesit në bazë të rregullës 6 të Rregullores për Ndihmë Juridike të Ndryshuar, Zyra Administrative i mori pas 22 shkurtit 2024:



- Z. Eduards parashtrroi një kërkesë për ndihmë juridike, në emër të klientit të tij, z. Kilaj, më 15 prill 2024;
 - Dr. Geri parashtrroi një kërkesë për ndihmë juridike, në emër të klientit të saj z. Bahtijari, më 16 prill 2024;
 - Z. Kadman parashtrroi një kërkesë për ndihmë juridike, në emër të klientit të tij z. Shala, më 2 maj 2024;
 - Z. Ris parashtrroi një kërkesë për ndihmë juridike, në emër të klientit të tij, z. Januzi, më 29 maj 2024.
16. Krahas mendimeve të shtjelluara në paragrafët 10-12 më lart, Avokati i Popullit nuk sheh se si katër parashtruesit, ose mbrojtësit e tyre do të kishin të drejtën për t'u konsultuar ose njoftuar për ndryshimet e propozuara në Rregulloren për Ndihmë Juridike të vitit 2020, duke pasur parasysh se ata paraqitën kërkesën për ndihmë juridike nga DHSK-ja disa muaj pas ndryshimit të Rregullores për Ndihmë Juridike. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit hedh poshtë parashtrimin e katër parashtruesve se ata janë *“dukshëm palë të interesuara”*.
17. Në bazë të rregullës 29(3)(b), Avokati i Popullit duhet ta hedhë poshtë këtë pjesë të ankesës në tërësi, sepse parashtruesit nuk kanë vërtetuar se procesi, i cili çoi në Rregulloren e vitit 2024, ka ndërhyrë ose shkelur të drejtat e tyre themelore për gjykim të drejtë.

B) Mosnxjerrja

18. Në parashtrimin drejtuar DHSGJK-së, në emër të parashtruesve, mbrojtësit parashtruan se Administratorja kishte refuzuar të bënte publike procedurën e ndryshimit, megjithëse neni 41 i Kushtetutës përcakton të drejtën e përgjithshme për të pasur qasje në dokumente publike.
19. Mbrojtësit i referohen rregullës 3(2) të Rregullores për Ndihmë Juridike e cila thotë se Administratorja duhet të mbajë evidencë të procedurës së ndryshimit e cila i mundëson asaj që ta bëjë atë publike. Dispozita thotë se Administratorja *“mund ta bëjë publike procedurën e ndryshimit ose pjesë të saj”* (theksimi i shtuar), por nuk përfshin detyrimin për të vepruar kështu.
20. Mbrojtësit i referohen edhe nenit 41 të Kushtetutës së Kosovës (Kushtetuta), i cili parasheh të drejtën e përgjithshme për të pasur qasje në dokumente publike, duke parashtruar se kjo përfshin dokumentet e institucioneve dhe organeve publike të



autoriteteve shtetërore siç është Administratorja. Megjithatë, neni 41(2) thotë: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”*.

21. Avokati i Popullit rikujton nenin 62 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), i cili thotë se *“Duke i pasur parasysh rrethanat e sigurisë dhe privatësisë, dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Regjistrimit dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës”*, dhe më tej thotë se, *“E drejta e përgjithshme për të pasur qasje në të dhënat apo arkivat e Dhomave të Specializuara, përfshirë të Zyrës Administrative dhe të Zyrës së Prokurorit të specializuar, nuk ekziston”*. Avokati i Popullit është bindur se neni 62 i Ligjit përputhet me dispozitën që përmban përjashtimet të nenit 41(2) të Kushtetutës.
22. Në përputhje me nenin 62 të Ligjit, evidenca e procedurës së ndryshimit të Rregullores së Ndihmës Juridike nuk është dokument publik dhe Administratorja nuk ka asnjë detyrim për ta bërë atë publike. Mosekzistenca e të drejtës për të pasur qasje në këto dokumente rrjedh nga neni 41 i Kushtetutës.
23. Rrjedhimisht, në bazë të rregullës 29(3)(b) Avokati i Popullit duhet ta hedhë poshtë këtë pjesë të ankesës, sepse aty nuk demonstron se Dhomat e Specializuara shkelën të drejtat themelore të parashtruesve të ankesës.

V. PËRFUNDIM

24. Avokati i Popullit hedh poshtë ankesën në tërësi.

PIETRO SPERA

Avokat i Popullit, Dhomat e Specializuara të Kosovës

10 korrik 2024

Në Hagë, Holandë